



NJOFTIM PËR MEDIA MBI MBLEDHJEN E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Ditën e martë, më datë 6 Shtator 2016 u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në të cilën morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z. Gentian Sala	Kryetar
Z. Agron Gjekmarkaj	Anëtar
Z. Gledis Gjipali	Anëtar
Z. Piro Misha	Anëtar
Z. Sami Nezaj	Anëtar
Zj. Suela Musta	Anëtar
Z. Zylyftar Bregu	Anëtar

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Zgjedhjen e z. Sami Nezaj zëvendëskryetar të Autoritetit të Mediave Audiovizive. **(Vendim nr. 181, datë 06.09.2016).**
2. Kalimin në transmetime digjitale të subjekteve të autorizuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet kabllorë. **(Vendim nr. 182, datë 06.09.2016).**
3. Miratimin e ndryshimit të pagesave për përpunimin administrativ të kërkesave për pajisje me licencë për rrjet numerik kombëtar, miratuar me vendimin e AMA-s Nr. 6, datë 22.05.2013, pika 2, për operatorët numerik të rrjeteve kombëtare në shumën 500,000 lekë. **(Vendim nr. 183, datë 06.09.2016.)**
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Top Gold” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Top Gold”, me afat vlefshmërie 5 vjeçar. **(Vendim nr. 186, datë 06.09.2016).**
5. Rinovimin e licencës së subjektit person fizik Aristotel Petro, për subjektin audio privat vendor “Radio Alpo” me afat vlefshmërie 5 vjeçar. **(Vendim nr. 187, datë 06.09.2016).**
6. Zëvendësimin e licencës së shoqërisë “Amantia” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Amantia Tv”, me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit të subjektit televiziv privat vendor “Amantia Tv”, me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese. **(Vendim nr. 188, datë 06.09.2016).**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

7. Zëvendësimin e licencës së subjektit person fizik Gëzim Brahusa, licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Blu Sky”, me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit së subjektit audioviziv privat vendor “Tv Blu Sky”, me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese. **(Vendim nr. 189, datë 06.09.2016).**
8. Zëvendësimin e licencës të shoqërisë “Onufri Tv” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Onufri”, me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit së subjektit audioviziv privat vendor “Tv Onufri”, me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese. **(Vendim nr. 190, datë 06.09.2016).**
9. Zëvendësimin e licencës të shoqërisë “TV SOT 7” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv SOT 7”, me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit së subjektit audioviziv privat vendor “Tv SOT 7”, me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese. **(Vendim nr. 191, datë 06.09.2016).**
10. Rinovimin e autorizimit të personit fizik Eneritan Pupa, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Pupa”. **(Vendim nr. 192, datë 06.09.2016).**
11. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Altin Shkurti, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Orikumi”. **(Vendim nr. 193, datë 06.09.2016).**
12. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tv Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Vlora Cable”. **(Vendim nr. 194, datë 06.09.2016).**
13. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për subjektin shoqërinë “TRING TV” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV). **(Vendim nr. 195, datë 06.09.2016).**
14. Heqjen e autorizimit të subjektit person fizik Shpëtim Plaku, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Alb Pajovë”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për më shumë se një vit. **(Vendim nr. 184, datë 06.09.2016).**
15. Heqjen e autorizimit të shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Lissus”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për më shumë se një vit. **(Vendim nr. 185, datë 06.09.2016).**

Tiranë, 6 Shtator 2016

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE